

**UDHËZIM**  
**Nr. 52, datë 3.12.2015**

**PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE  
NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË  
DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me udhëzimin nr.11, datë 30.6.2016)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4, të nenit 76 dhe pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Përcaktimin e niveleve dhe testeve ndërkombëtare të 5 (pesë) gjuhëve të huaja, përkatësisht: gjuhës angleze, gjuhës frënge, gjuhës gjermane, gjuhës italiane dhe gjuhës spanjolle. Kandidatët, të cilët aplikojnë për t'u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në institucionet e arsimit të lartë, duhet të kenë nivel të njohjes së njërës prej gjuhëve të huaja, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.

2. Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të njohjes së gjuhëve, bëhet sipas tabelës bashkëlidhur këtij udhëzimi në referencë të pikëve të testeve të ndryshme ndërkombëtare dhe shërben si standard për njohjen e gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare përkatëse në Shqipëri.

3. Për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, ndërmjet nivelit B1 dhe nivelit C1. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret e tyre nivelin e gjuhës, që do të jetë kriter hyrës në programet e studimit të ofruara prej tyre në ciklin e dytë, brenda niveleve të sipërcituara në këtë pikë të udhëzimit. Për pranimin në programin e studimeve të ciklit të tretë, kandidati duhet të ketë njohje të gjuhës së huaj, të nivelit C1.

4. Kandidati që aplikon për t'u pranuar në programe studimi të ciklit të dytë apo të tretë në institucionin e arsimit të lartë, duhet të ketë certifikime dhe rezultate të testeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve, të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se 2 (dy) vjet nga momenti i lëshimit të tyre.

5. Dokumenti i njohjes së gjuhëve, mund të jetë një certifikatë, diplomë apo dëshmi, e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare.

6. Institucionet e arsimit të lartë duhet të shpallin në faqen zyrtare dhe ambientet e tyre:

a) Listën e niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare në referencë të përcaktimeve të tabelës 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi, të përcaktuar si kriter pranimi në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë në atë institucion;

b) Listën e subjekteve të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare.

7. Institucionet e arsimit të lartë duhet të garantojnë akses dhe mundësi të barabarta për të gjitha subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale mbi testimet ndërkombëtare dhe certifikimin të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

8. Institucionet e arsimit të lartë, përcaktojnë në rregulloret e tyre, modalitetet e dorëzimit dhe verifikimit të certifikimit të nivelit të njohjes së gjuhës së huaj, në përputhje me procedurat e tjera të pranimin të kandidatit në programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.

9. Subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, certifikimet e të cilëve do të shërbejnë në përmbushjen e detyrimit ligjor, duhet të:

a) Paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dokumentacionin ligjor për të drejtën e pronësisë intelektuale dhe ofrimin e testeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas procedurave dhe afateve kohore të publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

b) Nënshkruajnë marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me qëllim njohjen e të drejtës së subjektit për ofrimin e testeve, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, shkëmbimin e informacionit në lidhje

---

<sup>1</sup> Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.52, datë 3.12.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.248/2015.

Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.11, datë 30.6.2016, është botuar në Fletoren Zyrtare nr.157/2016.

me testimet ndërkombëtare, si dhe ofrimin e të dhënave për të gjithë kandidatët që aplikojnë në institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë apo të tretë.

*9/1. Certifikata, diploma apo dëshmia e lësuar nga subjektet që gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për ofrimin e testeve ndërkombëtare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, njihen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, pas konfirmimit të secilit dokument nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që kanë nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për testin përkatës, sipas tabelës 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi.*

10. *Shfuqizuar.*

11. Studentët e regjistruar në ciklin e dytë apo të tretë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë, të cilët nuk i janë nënshtruar testimit të gjuhës angleze, si dhe nuk kanë paraqitur dokumentacion pranë institucioneve të arsimit të lartë, sipas udhëzimit nr. 14, datë 28.3.2011, “Për njohjen e testeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, kryejnë testimin sipas këtij udhëzimi.

12. Udhëzimi i ministrit të MASH-it nr. 14, datë 28.3.2011, “Për njohjen e testeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në institucionet e arsimit të lartë”, shfuqizohet.

13. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Lindita Nikolla**

**Tabela 1**

Në mbështetje të Kuadrit të Referencave për Gjuhët të krijuar nga Këshilli i Europës (2001), Kuadrit të Përbashkët Europian të Referencave për Gjuhët, si dhe në bashkëpunim me Ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës të akredituara në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, njih testet e gjuhëve të huaja dhe nivelet si më poshtë:

Niveli	B1	B2	C1
<i>Gjuha angleze</i>			
<b>Cambridge</b>	<b>PET</b>	<b>FCE</b>	<b>CAE</b>
<b>IELTS</b>	<b>4.0 / 5.0</b>	<b>5.5 / 6.0</b>	<b>6.5 / 7.0</b>
<b>TOEFL Internet-based Test (iBT)</b>	<b>57/86</b>	<b>87/109</b>	<b>110/120</b>
<b>TOEFL Paper-based Test (ITP)</b>	<b>460</b>	<b>543</b>	<b>627</b>
<b>TOEIC</b>	<b>381 / 649</b>	<b>650/ 785</b>	<b>786 / 935</b>
<b>GESE</b>	<b>-</b>	<b>7, 8, 9</b>	<b>10, 11</b>
<b>APTIS</b>	<b>Aptis B1</b>	<b>Aptis B2</b>	<b>Aptis C</b>
<i>Gjuha gjermane</i>			
<b>Goethe-Institut</b>	<b>ZD</b>	<b>ZDFB</b>	<b>ZMP</b>
<b>TestDaF</b>	<b>-</b>	<b>TDN 3 - TDN4</b>	<b>TDN 5</b>
<i>Gjuha franceze</i>			
<b>TFI</b>	<b>345/604</b>	<b>605/824</b>	<b>825</b>
<b>DELF</b>	<b>DELFB1</b>	<b>DELFB2</b>	<b>DALFC1</b>
<b>TCF</b>	<b>TCF 300 - 399</b>	<b>TCF 400 - 499</b>	<b>TCF 500 - 599</b>
<b>TEF</b>	<b>TEF 361-540</b>	<b>TEF 541-698</b>	<b>TEF 699-833</b>
<i>Gjuha italiane</i>			
<b>Peruggia</b>	<b>CELI2 livello2</b>	<b>CELI3 livello3</b>	<b>CELI4 livello4</b>
<b>Sienna</b>	<b>CILS uno B1</b>	<b>CILS 2</b>	<b>CILS 3</b>
<i>Gjuha spanjolle</i>			
<b>DELE</b>	<b>DELE inicial</b>	<b>DELE intermedio</b>	<b>DELE superior</b>